



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada – Government*

*Ministria e Forcës së Sigurisë*  
*Ministarstvo Snaga Bezbednosti Ministry of Security Force*  
**Departamenti i Personelit/ Odsek za personal/Department for Personnel**

---

Në mbështetje të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me Rregulloren 2001/36 mbi SHCK-në, Urdhëresën Administrative Nr. 2003/2 dhe Udhëzimin Administrativ 2003/01, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës shpall këtë:

### **KONKURS**

**Titulli i punës:** **Zyrtar i Financave; FSK 2519**

**Mbikëqyrësi:** Shefi i Departamentit të Menaxhimit të Financave të KFT-së  
**Kohëzgjatja e kontratës:** 36 muaj  
**Niveli i pagës:** A 3  
**Orari:** I plotë  
**Vendi i punës:** KFT

**Përshkrimi i punës:** Forca e Sigurisë së Kosovës është forcë krejtësisht vullnetare e ndërtuar nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Misioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës, si instrument i sigurisë është që ta mbështesë Qeverinë e Republikës së Kosovës. Detyrat fillestare të Forcës së Sigurisë janë; Të marrë pjesë në operacionet për reagim ndaj krizave, përfshirë operacionet në mbështetje të paqës. Kjo do të përfshijë operacionet jashtë territorit të Republikës së Kosovës, ku dotë ftohet për këtë qëllim; të ndihmojë autoritetet civile në përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore, fatkeqësive dhe emergjencave tjera, madje edhe si pjesë e një përpjekjeje reaguese regjionale apo ndërkombëtare; të kryej shkatërrimin e mjeteve shpërthyes; të ndihmojë autoritetet civile përmes operacioneve të mbrojtjes civile. Forca e Sigurisë së Kosovës fillimisht do të përbëhet nga Komanda e Forcave Tokësore, Brigada e Reagimit të Shpejtë, Brigada e Mbështetjes së Operacioneve dhe Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes. Forca e Sigurisë së Kosovës do të përbëhet nga personeli profesional i sigurisë, personeli rezervë, personeli civil dhe rekrutet.

Departamenti i financave është njëri nga tetë departamentet e KFT-së i cili perbehet nga personeli i uniformuar dhe personeli civil. Përgjegjësia dhe qëllimi këtij departamenti është të planifikoj, organizoj dhe menagjoj çështjet financiare në KFT, të mbaj dhe mbikëqyrë librat e llogarive (kontabilitetit) mbi hyrjet dhe daljet e të gjitha transaksioneve që kanë të bëjnë me llogaritjet e shpenzimeve të planifikuara, të alokuara dhe të shpenzuara sipas standardeve mbi menagjimin e Financave Publike dhe akteve tjera që rrjedhin nga administrata lidhur me (shpenzimet në paga dhe mëditje, shpenzimet në mallra dhe shërbime, shpenzimet kapitale, donacionet dhe subvencionet për KFT-në. Njëherit bënë edhe implementimin e politikave dhe rregulloreve të MFSK-së rreth çështjeve financiare dhe buxhetit.

Zyrtari i financave është nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejt të Shefit të Departamentit dhe është përgjegjës për zbatimin e politikave dhe dispozitave ligjore për çështjet e financave.

**Qëllimi i postit:**

- Zyrtari do të ketë përgjegjësi kryerjen e detyrave të dhëna sipas mandatit.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Ndhimon zyrtaret tjerë në sektor rreth zbatimit të politikave dhe procedurave të përgatitjes së buxhetit për KFT-në në përputhje me linjat e shpenzimeve të alokuara sipas planifikimit të miratuara nga MEF-i,

- Punon si oficer ndërlidhës në mes KFT-së dhe njërive të saj dhe punon në punë ekipore me stafin në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe planifikimit vjetor të buxhetit,
- Kontrollon dokumentet financiare për saktësi dhe pajtueshmëri me rregullat dhe rregulloret para miratimit dhe nënshkrimit të tyre,
- Asiston njësitet e KFT-së gjatë paraqitjes së problemeve lidhur me pagesat dhe çështjet tjera,
- Të punoj ngushtë me zyrtarët tjerë në departament dhe departamentin homolog në MFSSK,
- Të planifikoj dhe menajtoj mjetet në para të gatshme dhe të siguroj mirëmbajtjen e dosjeve lidhur me transaksionet e përditshme financiare ,
- Të veproj si oficer certifikues nëse kjo kërkohet prej tij bazuar në instruksionet financiare,
- Përgatit raportet sa herë që kërkohet për nevojat e brendshme dhe të jashtme dhe jep sqarime për pasqyrat financiare.
- Informon shefin e departamentit lidhur me kërkesat, mundësitë, kufizimet dhe resurset me të cilat disponojnë,
- Raporton të shefi i departamentit për punën e kryer, punën e pa kryer dhe atë në progres.

#### **Shkathtësitë, përvoja dhe karakteristikat tjera:**

- Duhet të jetë profesional, me përvojë dhe i besueshëm si dhe i aftë që t'i kryej në mënyrë profesionale detyrat e dhëna sipas mandatit dhe ato shtesë brenda periudhës së pranueshme kohore.
- Duhet t'i ketë shkathtësitë e mira organizative.
- Duhet të përdor maturinë gjatë punës me njerëz dhe detyrën.
- Duhet të jetë i motivuar lartë dhe të ketë etik të fort pune.
- Ai/ajo duhet të jetë në mundësi që të punoj i/e mëvetësishme si dhe të punoj si ekip me punonjës të tjerë në përmbushjen e detyrave të dhëna.

#### **Kualifikimet e nevojshme:**

- Përgatitje universitare
- Përvojë profesionale në punë financiare në institucione apo agjenci.
- Njohuri të mira kompjuterike.
- Njohja e gjuhës e gjuhës shqipe apo serbe, e dëshirueshme gjuha angleze.

#### **Kualifikimet e dëshiruara:**

- Përvojë si zyrtar i financave

**Si të aplikoni:** Formularët për aplikim janë në dispozicion në Departamentin e Personelit të M-FSK-së, apo në web-faqen e M-FSK-së, [www.mksf-ks.org](http://www.mksf-ks.org) ,apo [www.ks-gov.net/mfsk](http://www.ks-gov.net/mfsk) ku gjendet shpallja e konkursit. Formularët duhet t'i dorëzohen Departamentit të Personelit personalisht, apo të dërgohen me postë në këtë adresë: **Ministria e FSK-së, Lagja Emshiri 1, 10000 Prishtinë, Departamenti Personelit, Kati II, (Ish-ndërtesa e Shtabit të Përgjithshëm të TMK-së)**, Prishtinë, në çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. Kandidatët duhet t'ia bashkëngjisin aplikacionit kopjet e dokumenteve që dëshmojnë përmbushjen e kushteve të nevojshme. **Numrat kontaktues:** Për informata plotësuese, mund të thirrni në numrin telefonik kontaktues nr.: 038 200 13 508. Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ditës së shpalljes së parë në të përditshmet kosovare. Data e fundit e aplikimit është 13.07.2010. Edhe aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, do të konsiderohen valide. Kandidatët duhet t'ia bashkëngjisin aplikacionit kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe kopjet e dokumenteve që dëshmojnë për kualifikimet e tij/saj. Kjo pozitë i nënshtrohet procesit të verifikimit dhe mund të plotësohet vetëm pas përfundimit të procesit të verifikimit. Për shkak të numrit të madh aplikacioneve, vetëm kandidatët e përzgjedhur dhe të shënuar në listën e shkurtë do të njoftohen. Kandidatët e ftuar në intervistë duhet t'i sjellin kopjet origjinale të dokumenteve të dorëzuara për rishikim. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!

**Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës iu shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mirëpret aplikacione të femrave dhe meshkujve, pa dallim nga përkatësia e tyre etnike.**